



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni Pranveror
Kryesia e Kuvendit
P-070

Prishtinë, më 26 qershor dhe 10 e 25 korrik 2023
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT,
E MBAJTUR MË 26 QERSHOR DHE 10 E 25 KORRIK 2023

E hënë, më 26 qershor 2023, ora 12:20

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani, nënkryetar i Kuvendit.

Munguan: Saranda Bogujevci dhe Enver Hoxhaj, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme për Shërbime Legjislative, Xheladin Hoxha, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Nuk pati kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Ndërsa, pas diskutimeve, kryetari vendosi që vazhdimi i gjashtë (6) seancave me pikat e papërfunduara të mbahet të enjten, më 29 qershor 2023, në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur 20 prill 2023:

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-221 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë dhe projektit ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, KOSTT (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a.) dhe KFW, Frankfurt Am Main (KFW) për Projektin -Zhvillimi i sektorit të energjisë VII – përmirësimi i rrjetit të transmetimit,
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-222 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për Projektin “Ngrohja solare e Prishtinës”,
9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
10. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për shpenzimet e parasë publike për dy vite mandat të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

II. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 26 prill 2023:

1. Votimi i Propozim Rezolutës nga debati parlamentar lidhur me zhvillimet në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe përgjegjësinë e institucioneve qendrore në sektorin energjetik.

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 4 maj 2023:

6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-223 për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave të arsimit të lartë në nivelin master në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë,
7. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-153 për edukimin në fëmijërinë e hershme,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligji nr. 08/L-219 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, personat e dhunuar gjatë luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-172,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-207 për tekstet shkollore,
12. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 21/136, datë 22. 3. 2023 për themelimin e Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit (IBCM) me seli në Mitrovicë si Institucion i arsimit të Lartë,
13. Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me raportin e auditimit të performancës menaxhimi i projektit “Bashkimi i qytetit të Ferizajt”.

IV. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 22 qershor 2023:

4. Votimi i Projekt-Rezolutës nga interpelanca me ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati për çështjen: “Rishikimi i buxhetit të Republikës së Kosovës dhe rritja e pagave në sektorin publik”.

V. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8 dhe 15 qershor 2023:

22. Votimi për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
23. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

VI. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 6, 7 prill dhe 7 qershor 2023:

4. Votimi i Propozim-Rezolutës për punën dyvjeçare të Qeverisë së Kosovës.

Pastaj, kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

* * *

E hënë, më 10 korrik 2023, ora 10:25

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e filluar më 26 qershor 2023

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.

Munguan: Enver Hoxhaj dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila dhe Abelard Tahiri.

Munguan: kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi; kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri dhe kryetari i GP Multietnik, Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se ditën e sotme, datë 10 korrik 2023, janë caktuar që të mbahen dy seanca.

I. Vazhdimi i seancave me pikat e papërfunduara, në orën 11:00.

II. Seancë e jashtëzakonshme, me kërkesë të 41 deputetëve nga GP i LVV-së dhe GP Multietnik, në orën 13:00, me këtë:

Rend dite

1. Ratifikimi i anëtarit të Këshillit Shtetërorë të Cilësisë në Agjencinë Kosovare të Akreditimit.

Ndërsa, kryetari deklaroi se seanca plenare e re mund të mbahet të enjten, më 13 korrik 2023, me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,

2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,

3. Pyetjet parlamentare,

4. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,

5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-234 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për programin e financave publike dhe rritjes ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar,*
6. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-236 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përbarimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-199 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore,*
9. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë,*
10. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-191 për ekspertët gjyqësor,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore,*
12. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-190 për zhvillim rajonal të balancuar,*
13. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-200 për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse,*
14. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-201 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-081 për energjinë,*
15. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-227 për përfaqësimin e institucioneve shtetërore në procedura gjyqësore dhe Arbitrazh,*
16. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-237 për kadastër të pronës së paluajtshme,*
17. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-238 për Fondin Sovran të Republikës së Kosovës,*
18. *Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-009 për ndërmjetësim,*
19. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve nga radhët e komunitetit shqiptar në Komisionin e Pavarur për Media,*
20. *Emërimi i kryesuesit dhe i një (1) anëtari të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit,*
21. *Zgjedhja e Komisionarit Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës,*
22. *Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE.*

Në lidhje me pikën nr. 19 të lartshënuar, kryetari dha sqarime se grupet parlamentare duhet që në seancë plenare t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve nga radhët e komunitetit shqiptar në Komisionin e Pavarur për Media.

Ndërsa, me kërkesë të kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri, u shty radhitja për seancë plenare e pikës: Interpelanca me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, në lidhje me çështjen: “Përgjegjësia e tij në raport me ambasadorin e Republikës së Kosovës në Kroaci, z. Martin Berishaj”.

Pastaj, kryetari deklaroi se nëse caktohet mbajtja e seancës plenare të lartshënuar, do të ketë njoftim me kohë.

Në fund, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit nuk mund të shqyrtohen propozimet dhe kërkesat e parashtruara për Kryesinë e Kuvendit.

Kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë në orën 10:35 minuta.

* * *

E martë, më 25 korrik 2023, ora 11:15

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e filluar më 26 qershor 2023

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.

Mungoi: Saranda Bogujevci, nënkryetare e Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: kryetari i GP Multietnik, Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të re,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 12 dhe 16 qershor 2023

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 12 dhe 16 qershor 2023.

Më pas, kryetari i njoftoi të pranishmit se kjo është java e fundit e punimeve të Kuvendit për Sesionin pranveror.

Pastaj, ai procedoi me pikat tjera të rendit të ditës.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

Pas diskutimeve, kryetari vendosi që vazhdimi i pesë (5) seancave me pikat e papërfunduara të mbahet të enjten, më 27 korrik 2023, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 20 prill, 29 qershor dhe 10 korrik 2023:

9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
10. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për shpenzimet e parasë publike për dy vite mandat të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

II. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 4 maj dhe 10 korrik 2023:

13. Votimi i rekomandimit lidhur me raportin e auditimit të performansës menaxhimi i projektit “Bashkimi i qytetit të Ferizajt”.

III. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 22 qershor 2023:

4. Votimi i Projekt-Rezolutës nga interpelanca me ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati për çështjen: “Rishikimi i buxhetit të Republikës së Kosovës dhe rritja e pagave në sektorin publik”.

IV. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8 dhe 15 qershor 2023:

22. Votimi për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
23. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

V. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 6, 7 prill dhe 7 qershor 2023:

4. Votimi i Propozim-Rezolutës për punën dyvjeçare të Qeverisë së Kosovës.

3. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të re

Kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri kërkoi nga kryetari i Kuvendit që seancat plenare të Kuvendit të thirren në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, si dhe bëri vërejtje për thirrjen e një seance plenare të mëparshme në lidhje me miratimin e rendit të ditës, pasi Kryesia e Kuvendit nuk kishte kuorum, dhe për afatet për shpërndarjen e materialit të seancës, për të cilën seancë ai deklaroi se i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Diskutimi i plotë i z. Tahiri është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutoi kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Me kërkesë të kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri, u shty përsëri radhitja për seancë plenare e pikës: Interpelanca me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, në lidhje me çështjen: “Përgjegjësia e tij në raport me ambasadorin e Republikës së Kosovës në Kroaci, z. Martin Berishaj”.

Më pas, kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, propozoi që të radhitet në rendin e ditës të seancës plenare pika - Debat parlamentar në lidhje me publikimin e audio-incizimeve të kryetares së GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, me ish-nënkryetarin e Kuvendit, Slavko Simiq.

Diskutimi i plotë i z. Tahiri është dhënë në transkript.

Në lidhje me propozimin e lartshënuar, diskutuan: kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila; kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri; nënkryetari i Kuvendit, Enver Hoxhaj; kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, dhe kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte:

Për - 2 vota (nënkryetarët e Kuvendit: Enver Hoxhaj dhe Kujtim Shala),

Kundër - 0 vota,

Abstenim - 2 vota (kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe nënkryetari i Kuvendit, Bahrim Shabani).

Me rezultatin e lartshënuar, nuk u radhit në rendin e ditës të seancës plenare të re, pika - Debat parlamentar në lidhje me publikimin e audio-incizimeve të kryetares së GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, me ish-nënkryetarin e Kuvendit, Slavko Simiq, e propozuar nga kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri.

Kryetari, pas diskutimeve për rendin e ditës të propozuar për seancë plenare, pa miratimin e tij me konsensus, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të premten, më 28 korrik 2023, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
- 2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 3. Pyetjet parlamentare,*
- 4. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,*
- 5. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-221 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë dhe projektit ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, KOSTT (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a.) dhe KFW, Frankfurt Am Main (KFW) për Projektin - Zhvillimi i sektorit të energjisë VII - përmirësimi i rrjetit të transmetimit,*
- 6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-222 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për Projektin “Ngrohtorja solare e Prishtinës”,*

7. *Votimi i Projektligjit nr. 08/L-223 për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave të arsimit të lartë në nivelin master në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë,*
8. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-207 për tekstet shkollore,*
9. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-234 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për programin e financave publike dhe rritjes ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar,*
10. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-236 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze,*
11. *Zgjedhja e Komisionarit Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës,*
12. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve nga radhët e komunitetit shqiptarë në Komisionin e Pavarur për Media,*
13. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për ekonomi, industri, ndërmarrësi dhe tregti për shkarkimin e kryesueses dhe anëtarët e Bordit të Komisionit për Pavarur për Miniera dhe Minerale,*
14. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-125 për pronën publike,*
15. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale,*
16. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës,*
17. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-187 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale,*
18. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-194 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës,*
19. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-245 për artin dhe kulturën,*
20. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor,*
21. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-242 për performansën energjetike të ndërtesave,*
22. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-246 për administrimin e ndërtesave dhe lagjeve të banimit në bashkëpronësi,*
23. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-239 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-128,*
24. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-240 për Agjencinë e Regjistrimit Civil.*

* * *

Në vazhdim, nënkryetari i Kuvendit, Enver Hoxhaj, deklaroi se ai nuk e bën kuorumin për miratimin me konsensus të rendit të ditës të seancës plenare të re, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Projekt-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08-Rr-007 për strukturën organizative dhe klasifikimin e pozitave të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi, e paraqiti dhe e arsyetoi Projekt-Rregulloren e lartshënuar, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me Projekt-Rregulloren e lartshënuar diskutoi nënkryetari i Kuvendit, Enver Hoxhaj, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin e Projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08-Rr-007 për strukturën organizative dhe klasifikimin e pozitave të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit, ishte:

Për - 4 vota,

Kundër - 0 vota,

Abstenim - 0 vota.

Pas votimit, kryetari konstatoi se Kryesia e miratoi Rregulloren nr. 08-Rr-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08/Rr-007 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Nëpunësve Civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesia mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja nr. 08-Rr-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08/Rr-007 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Nëpunësve Civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Rregullorja nga pika një (1) e këtij vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas miratimit nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Rregullorja nga pika një (1) e këtij vendimi publikohet në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Projekt-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08-Rr-005 së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi, e paraqiti dhe e arsyeoi Projekt-Rregulloren e lartshënuar, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin e Projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08-Rr-005 së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit, ishte:

Për - 4 vota,

Kundër - 0 vota,

Abstenim - 0 vota.

Pas votimit, kryetari konstatoi se Kryesia e miratoi Rregulloren nr. 08-Rr-010 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08-Rr-005 së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesia mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja nr. 08-Rr-010 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 08-Rr-005 së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Rregullorja nga pika një (1) e këtij vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas miratimit nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Rregullorja nga pika një (1) e këtij vendimi publikohet në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i mocionit: Projekt-Deklaratë për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kryesia e shtyu shqyrtimin dhe procedimin e mocionit të lartshënuar, me qëllim të konsultimit me propozuesin dhe harmonizimit para se të procedohet për seancë plenare.

4. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2024, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfere 2024/1

Kryesia, me rekomandim të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2024, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve 2024/01.
2. Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i rekomandohet që të njëjtat kërkesa t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2024.

5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2023

Kryesia, pasi e shqyrtoi Raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2023.

2. Autorizohet Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta publikojë Raportin nga pika një (1) e këtij vendimi.

6. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mbretërinë e Bashkuar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Besian Mustafa i lejohet udhëtimi zyrtar në Londër (Mbretëri e Bashkuar), prej datës 30 gusht deri më 2 shtator 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit, të pajisjes me vizë dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mbretërinë e Bashkuar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Shqipe Mehmeti-Selimi i lejohet udhëtimi zyrtar në Londër (Mbretëri e Bashkuar), prej datës 29 gusht deri më 2 shtator 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

8. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Francë

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Paris (Francë), prej datës 29 qershor deri më 2 korrik 2023.

9. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Hyseni, Xhavit Haliti, Rashit Qalaj, Alban Bajrami, Shqipe Mehmeti-Selimi, Luan Aliu, Vlora Dumoshi, Agim Veliu, Albana Bytyqi dhe Erxhan Galushi u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej datës 3 deri më 5 shtator 2023.

2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori (AP e NATO-s), ndërsa shpenzimet e udhëtimit, të transportit, të pajisjeve me viza dhe mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

10. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni të Veriut

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jeta Statovci i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Shkup (Maqedoni e Veriut), prej datës 21 deri më 23 korrik 2023.

11. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Austri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj i lejohet udhëtimi zyrtar në Austri, prej datës 26 gusht deri më 2 shtator 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

12. Kërkesa për ndryshimin e vendimit për udhëtimin zyrtar në Gjeorgji

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

për ndryshimin e Vendimit nr. 08-V-421, datë: 13. 3. 2023

1. Në pikën 1 të Vendimit nr. 08-V-421, datë: 13. 3. 2023, ndryshohen datat e realizimit të udhëtimit zyrtar në Tbilisi (Gjeorgji): nga datat 3 deri më 9 korrik 2023, në datat 4 deri më 10 korrik 2023.
2. Udhëtimin zyrtar nga pika një (1) e vendimit nr. 08-V-421, datë: 13. 3. 2023, e ka realizuar vetëm deputeti Dimal Basha.

13. Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Katar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazmend Gjyshinca i kompensohen shpenzimet e biletës së udhëtimit në shumën prej 673,31 euro, në lidhje me udhëtimin zyrtar, të realizuar në Katar, prej datës 21 deri më 25 maj 2023.

14. Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Albena Reshitaj i kompensohet mëditja edhe për një (1) ditë (për datën 11.06.2023), nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prej datës 4 deri më 11 qershor 2023.

15. Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Izrael

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti i mbulohen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditja edhe për një (1) ditë shtesë (për datën 15. 6. 2023), nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Izrael, prej datës 11 deri më 15 qershor 2023.

16. Konfirmimi i vendimit për lejimin e vizitës zyrtare në Kosovë të delegacioneve të Kuvendit të Shqipërisë dhe të Parlamentit të Belgjikës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s dhe mbulimin e disa shpenzimeve

Kryesia, në lidhje me vizitën zyrtare në Kosovë të delegacioneve të Kuvendit të Shqipërisë dhe të Parlamentit të Belgjikës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s dhe për mbulimin e disa shpenzimeve, mori këtë:

V E N D I M

Konfirmohet Vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 08-V-521, datë 10. 7. 2023 për lejimin e vizitës zyrtare në Republikën e Kosovës, të delegacioneve të Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit të Belgjikës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, prej datës 13 deri më 15 korrik 2023 dhe për mbulimin e shpenzimeve sipas kërkesës nr. 08/4054/Do-1774, datë 21. 6. 2023.

17. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Francë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e transportit/taksisë në shumën prej 355,00 euro, të shpenzuara nga Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, gjatë realizimit të udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë), prej datës 18 deri më 21 qershor 2023.

18. Raportet për vizitat zyrtare

Kryesia e Kuvendit është njoftuar, përmes raporteve me shkrim për realizimin e vizitave zyrtare, si në vijim:

- nga kryetari i Grupit të Miqësisë me Izraelin, Avdullah Hoti, në lidhje me vizitën zyrtare të këtij Grupi të Miqësisë, të realizuar në Izrael, prej datës 11 deri më 15 qershor 2023.

- nga kryesuesi i Delegacionit në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Driton Hyseni, në lidhje me pjesëmarrjen e këtij Delegacioni në punimet e Sesionit Vjetor të AP të NATO-s, të zhvilluar në Luksemburg, prej datës 19 deri më 23 maj 2023.

- nga kryetari i Grupit të Miqësisë me Austrinë, Anton Quni, në lidhje me takimin e këtij Grupi të Miqësisë me një delegacion 20 anëtarësh nga Parlamenti i Austrisë, të mbajtur në Kosovë, më 15 maj 2023.

- nga kryetari i Grupit të Miqësisë me Austrinë, Anton Quni, në lidhje me takimin e këtij Grupi të Miqësisë me Grupin homolog të Miqësisë të Parlamentit të Austrisë, të mbajtur po ashtu në Kosovë, më 19 qershor 2023.

Kryetari e mbylli mbledhjen në ora 12:41 minuta.

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale